Ju porosis të keni frikë Allahun dhe të jeni të dëgjueshëm e të bindur, edhe nëse ju bëhet prijës ndonjë rob abisinas. Pas meje do të shihni kundërshti të shumta, andaj kapuni fort pas traditës sime dhe traditës së kalifëve të drejtë e të përudhur

Irbad ibën Sarije (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: Një ditë i Dërguari i Allahut u ngrit dhe na këshilloi me një këshillë drithëruese, që na i trondити zemrat e na i përloti sytë. Atëherë ne i thamë: "O i Dërguari i Allahut, këto fjalë po na duken sikur janë këshillë lamtumirëse, andaj na porosit!" Ai tha: "Ju porosis të keni frikë Allahun dhe të jeni të dëgjueshëm e të bindur, edhe nëse ju bëhet prijës ndonjë rob abisinas. Pas meje do të shihni kundërshti të shumta, andaj kapuni fort pas traditës sime dhe traditës së kalifëve të drejtë e të përudhur, shtrëngojeni me dhëmballë dhe ruajuni nga gjërat e shpikura, sepse çdo bidat është lajthitje."

[Sahih] [Transmetojnë Ebu Davudi, Tirmidhiu, ibn Maxhe dhe Ahmedi]

Profeti i këshilloi shokët e tij me një këshillë drithëruese, prej së cilës zemrat u trondитën dhe sytë u përlotën. Atëherë ata i thanë: "O i Dërguari i Allahut, këto fjalë po na duken sikur janë këshillë lamtumirëse!" Kjo, pasi panë se Profeti i këshilloi drithërueshëm, prandaj kërkuan një porosi që t'i përmbahen asaj. Profeti u tha: "Ju porosis që ta keni frikë Allahun e Lartmadhëruar, duke i kryer obligimet dhe duke i braktisur gjërat e ndaluara, të jeni të dëgjueshëm dhe të bindur, pra, ndaj prijësve, edhe nëse një rob bëhet prijës (i vendit) ose udhëheqës (për ndonjë çështje të veçantë), respektivisht edhe nëse njeriu më i ulët bëhet prijës për ju, mos u zbrapsni nga kjo dhe bindjuni atij, nga frika se ndodhin fitne (trazira e telashe), sepse kushdo nga ju që jeton do të shohë kundërshti të shumta. Pastaj ai ua shpjegoi atyre rrugën e daljes nga kjo kundërshti, pra, duke u kapur fort pas traditës së tij dhe traditës së kalifëve të drejtë e të udhëzuar pas tij: Ebu Bekër Sidikut, Omer ibn Hatabit, Othman ibn Afanit dhe Ali ibn Ebu Talibit (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë!) dhe shtrëngimi i saj me dhëmballë. Me këtë kishte për qëllm të jemi të përpiktë duke u kapur fort për të. Po ashtu ua tërhoqi vërejtjen nga çështjet e shpikura dhe bidatet (risitë) në fe, sepse çdo bidat është devijim.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/65057